



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1382 Prot.

Lezhë, më 28 . 01 . 2021

VENDIM

Nr. 10 Datë 27 . 01 . 2021

PËR
MIRATIMIN E ZGJEDHJEVE TË ANËTARËVE TË KRYESISË DHE TË
KRYETARËVE TË FSHATRAVE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE
SHËNGJIN

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” nenet 8, 53, 54 dhe 70; në përputhje me Vendimin Nr. 113, datë 26.08.2020 i ndryshuar, pasi u njoh me materialin zgjedhor dhe me propozim të Kryesisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI :

1. Të miratojë zgjedhjet e Anëtarëve të Kryesisë dhe të Kryetarëve të Fshatrave në Njësinë Administrative Shëngjin, të cilët janë:

Nr	Fshati	Kryetar Fshati	Anëtarët e Kryesisë së Fshatit
1	Ishull Lezhë	Kreshnik Ndue Toni	1. Tom Kol Gjelij 2. Zef Llesh Prenga 3. Ndoc Kol Gjelij 4. Marash Loshi 5. Kreshnik Ndue Toni
2	Ishull Shëngjin	Çesk Nikoll Toma	1. Bled Pati 2. Sebastian Malotaj 3. Çesk Toma 4. Eduart Malaj 5. Ndue Mirashi
3	Kodër Mulliri	Ndue Prel Lekaj	1. Klodian Rrok Vuçaj 2. Ded Ndue Lleshi 3. Petrit Mark Suli 4. Ndue Prel Lekaj 5. Mark Preng Kola
4	Mali i Rrencit	Aleksander Albert Luli	1. Aleksander Albert Luli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHE
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

2. Brenda datës 28.02.2021 të mblidhen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse vulat ekzistuese të çdo fshati.
3. Të merren të gjitha masat nga Kryetari i Bashkisë për përgatitjen e vulave të reja, në rast se ka vula të dëmtuara dhe brenda muajit shkurt 2021 t'u dorëzohen vulat Kryetarëve të Fshatrave të miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Aparati i Bashkisë të marrë të gjitha masat për njoftimin e ish Kryetarëve të Fshatrave për dorëzimin e dokumentacionit të Kryetarët e Fshatrave të zgjedhur dhe të miratuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, detyrë e cila duhet të përfundojë brenda datës 28.02.2021.
5. Kur ka raste të mosdorëzimit të dokumentacionit dhe vulës nga ish Kryetarët e Fshatrave brenda afatit të përcaktuar në pikat 2 dhe 4 të këtij vendimi, autorizohet Kryetari i Këshillit të Bashkisë për të bërë denoncimin në organet ligjore.
6. Shpërblimi mujor për Kryetarët e Fshatrave, të zgjedhur dhe miratuar sipas këtij vendimi, fillon në muajin shkurt 2021.
7. Ky vendim t'u bëhet i njohur nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë, në rrugë zyrtare, të gjitha institucioneve shtetërore që trajtojnë probleme me pronat.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

